



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0121

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Ermal Sylaj B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën - Suharekë - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-12927-5-2-1, me 11.04.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE Ermal Sylaj B.I. me nr. 2025/0121 , e datës 14.02.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunë - Suharekë - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-12927-5-2-1.
2. **Mbtet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA SUHAREKË, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën - Suharekë - RITENDER" me numër të prokurimit 624-24-12927-5-2-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Ermal Sylaj B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.12.2024 KOMUNA SUHAREKË., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën - Suharekë - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-12927-5-2-1.

Me 31.01.2025, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka shpërblyer me kontratë GOE ERST BAU SH.P.K., ARLINDI SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë me vlerë të kontratës 400,000.00 euro.

Me 04.02.2025 OE Ermal Sylaj B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 07.02.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.02.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Ermal Sylaj B.I., me numër protokolli 2025/0121 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën - Suharekë - RITENDER me numër të prokurimit 624-24-12927-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Ermal Sylaj B.I., janë parashtruar si në vijim:

Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.).

Ndërsa në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) e që do të shtjellohen në mënyrë të detajuar edhe më poshtë mirëpo së pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tonë dhe kundërligjshmërinë e Autoritetit Kontraktues për të na eliminuar neve.

Dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar:

GOE ka prezentuar Ingj. Ilaz Hajdin Vokrri, Ingj. I ndertimtaris Drejtim Hidroteknik, me Kontrate të rregullt pune duke filluar nga data 01.02.2024 me orara të plote dhe CV e të njejtit rezulton se në kompaninë Bini Shpk ka filluar pune nga viti 2023, ndërsa pas verifikimit në sistemin e ATK –se rezulton se ING Ilaz Vokrri ka filluar pune në kompaninë NBT BINI Shpk nga muaji 03/2024 si pune sekondare dhe jo sipas kontratës së firmosur për pune me orar të plote dhe CV e Ingj. Ilaz Vokrri nuk korrespondon fare me kontratën dhe lajmerimit në sistemin e ATK-se. Gjithashtu, referenca e Kompanisë NNT BINI Shpk leshuar ndaj Ing Ilaz Vokrri është e pavlefshme (data e fillimit të punës: 01.05.2023).

Inxhinieri në fjalë ka qënë i angazhuar në kompaninë NNT "Bini" gjatë vitit 2023 me një kontratë për kohë të caktuar gjatë vitit 2023, pas profesionalizmit të shfaqur gjatë angazhimit në vitin 2023, ne kemi lidhur kontratën prej vitit 2024 me një kontratë për kohë të pacaktuar ashtu edhe siq e kemi prezantuar edhe me rastin e ofertimit ndërsa performanca që ka shfaqur në

menaxhimin e projektit edhe sipas referencës së lëshuar nga ana e Komunës së Podujevës dhe ashtu siq është e shkruar në CV, Inxhinieri është angazhuar në kompaninë NNT”Bini” sipas kontratës së prezantuar, dhe si e tillë përmbush gjitha kërkesat e kontratës sipas Ligjit të punës Nr. 03/L-212 dhe përmbush të gjitha kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, e që në këtë rast ne kemi përmbushur

Ndërsa Ligji nuk e ndalon që një person i cili është i angazhuar me orarë të plotë të deklarohet me punë sekondare, ndërsa saj përket angazhimit të tij në kompani dhe përvojës së tij, më së miri e dëshmojnë edhe Referencat e lëshuara nga Autoritetet Kontraktues.

Në dëshmitë për inxhinierin në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit, nuk është kërkuar që të ofrohet një dëshmi nëse personi në fjalë do të jetë i angazhuar në kompaninë tonë me pagë primare apo Sekondare, është kërkuar një kontratë e punës valide e noterizuar, e në këtë rast ne kemi përmbushur këtë kërkesë ku në rastin konkret si dhe është i deklaruar në ATK sipas ligjit, në rast të ndonjë dyshimi konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi në fazën e rivlerësimit, konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së në rast të ndonjë dyshimi, mund të kërkojë që të konfirmohet edhe angazhimi i Inxhinierit duke komunikuar edhe me Inxhinierin në lidhje me angazhimin e tij dhe pozicionin e tij në këtë projekt dhe në kompani. Andaj, mbetet në përgjegjësi të AK që implementimin e kontratës ta bëjë konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të kërkojë të konfirmohet drejtëpërdrejtë angazhimi i z. Ilaz Vokri se si do të jetë angazhimi i tij nëse fitohet kontrata nga OE.

Pra ne kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë të cilat janë përmendur ne dosje te tenderit dhe një kërkesë për të cilën e ka cekur AK ne letër standarde te tenderuesit te eliminuar nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit ku me këtë veprim te eliminimit tonë AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së ku thuhet:“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Me rastin e eliminimit të kompanisë sonë, shihet qartas që ka vepruar në kundërshtim me Rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik 40.13-Duke mos bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit. Ndërsa, duke e ditur që ne si tenderues kemi ofruar. ofertën më të mirë sipas kriterëve për dhënien e kontratës, në bazë të Rregullores për prokurim publik, 45.33, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar vlerësimin e ofertës jashtë kriterëve të cilat nuk kanë qenë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që të mos jetë në aspektin material të njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nuk janë prekur. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve pika.2 AK ka mundur që të kërkojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahasimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzuesëve dhe Rregulloreve.

Ndërsa Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur Fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë e këtë do të shtjellojmë me shkeljet të cilat janë bërë.

Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 2- është kërkuar si në vijim: Kërkesa 2 – OE duhet te kete Staf i profesional si për kërkesën:

-Nje (1) Inxhinier i diplomuar I Ndertimtarise (ose master) - hidroteknik min 5 vite pervoj pune pase diplomimit.

Është kërkuar kontrata të punës valide te noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim te noterizuara. Ku për këtë pikë është prezantuar: Selim Hyseni-ndërsa është prezantuar një “Draft” Kontratë pune për detyra specifike, ku në bazë LIGJI Nr. 03/L-212-Neni 10- Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, të caktuar si dhe kontratë për punë dhe detyra specifike, në këtë ligj nuk ekziston lloji “Draft” Kontratë pune për detyrë specifike. Si e tillë kontrata e prezantuar nuk përmbush kërkesën.

- Nje (1) Një inxhinier i Gjeodezisë (ose master) - te jete i licencuar si dhe te kete min 3 vite pervoj pune pase diplomimit.

Në Kosovë, nostrifikimi i diplomave universitare të fituara jashtë vendit është i rregulluar nga Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore të nxjerra nga institucionet përkatëse. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që diplomat e fituara jashtë vendit të njihen dhe të konsiderohen të barasvlershme me sistemin arsimor të Kosovës.

Nëse një person i diplomuar jashtë Kosovës aplikon në një tender publik në Kosovë dhe diploma e tij duhet të përmbush kushtet e tenderit, nostrifikimi i diplomës është i domosdoshëm. Arsyeja është se nostrifikimi është procesi që zyrtarisht e bën një diplomë të fituar jashtë vendit të vlefshme dhe të barasvlershme me diplomat e njohura brenda sistemit arsimor të Kosovës.

Aplikimi në tender dhe shpallja si fitues:

- Nëse diploma është kërkesë në tender dhe nuk është e nostrifikuar, personi mund të skualifikohet për mosplotësim të kushteve.

- Në praktikë, autoritetet kontraktuese kanë për detyrë të shqyrtojnë dokumentet e dorëzuara dhe të sigurohen se të gjitha kushtet e kërkuara (përfshirë vlefshmërinë e diplomës) janë përmbushur.

Përfundimi:

- Për të marrë pjesë në tender publik dhe për të pasur mundësi të shpallet fitues, personi duhet ta ketë të nostrifikuar diplomën edhe nëse një dokument i tillë nuk është kërkuar, E që në rastin konkret për Inxhinierin e Gjeodezisë nuk është prezantuar një dokument i tillë.

Autoriteti Kontaktues në përgjigjien pas kërkesës për rishqyrtim ka përmendur një marrëveshje që është e lidhur me datën 26.11.2021, për njohjen e diplomave të Shqipërisë, ndërsa mbrojtja e diplomës është 28.07.2020, dhe data e lëshimit të diplomës është 29.10.2021, që nuk përfshihet në këtë marrëveshje pasi që marrëveshja e lidhur është pas datës së diplomimit dhe marrëveshja e lidhur ka të bëjë me njohjen e gradave pas marrëveshjes.

- Nje (1) Inxhinier i diplomuar I Ndertimtarise (ose master) – hidroteknik min 5 vite pervoje pune i certifikuar per organizim dhe menaxhim I kantierit te ndertimit, i njejtj te jete menaxher i projektit Është kërkuar kontrata të punës valide te noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim te noterizuara. Ku për këtë pikë është prezantuar:Faton Frangu -Ku për inxhinierin në fjalë është

prezantuar “Draft” Kontratë pune për detyra specifike, ku në bazë LIGJI Nr. 03/L- 212-Neni 10-Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, të caktuar si dhe kontratë për punë dhe detyra specifike, në këtë ligj nuk ekziston lloji “Draft” Kontratë pune për detyrë specifike.

- Nje person i trajnuar per trajtimin e mbetjeve inerte & 6. Nje person i trajnuar per drenazhim te dheut, Për piken 5 dhe 6 te deshmohet me kontrata te punes ose marrëveshje mbi angazhim ne kete projekt dhe certifikatat e noterizuar nga vete mbajtesit e saj te leshuar nga kombetare apo nderkombetare dhe jo para dates te publikimit te njoftimit per kontrate.

Të dy certifikatat e prezantuara për këta dy persona janë certifikata të falsifikuara pasi që numër i referencës si dhe datë të njëjtë të lëmit po i njëjti për të dy persona të ndryshëm.

Ndërsa është kërkuar që këto certifikata të jenë të lëshuara nga kombetare apo ndërkombetare, ndërsa lëshuesi i kësaj Certificate: Bazuar në kërkesat ligjore, përkatësisht Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-161 dhe Rregulloren përkatëse 01/2021 të MPMS, kompania Bliterm ENG posedon Licencë për ushtrimin e veprimtarive në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MFPT dhe nuk Organ i Akredituar apo i Certifikuar nga MPMS. për trajnime për mbetjen Inerte si dhe Trajnime për Sistemet e Drenazhimit.

Është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues që të bëjë edhe verifikimin e dokumenteve të prezantuara nga ana e Ofertuesve, ku në këtë rast shihet qartas që dokumentet (Certifikatat e Prezantuara) nga ana e OE të shpallur të përgjegjshëm nuk janë certifikata në rregull ndërsa në baë të rregullores për prokurim publik: 47.16 Verifikimi i përshtatshmërisë, dhe kualifikimeve të tenderuesve, bëhet përmes Letrës standarde B47 “Kërkese për sqarimin e tenderit/aplikacionit” përmes platformës elektronike, Neni 67-Provat Shkresore pika 2 është dashur që të bëhet edhe verifikimi i përshtatshmërive profesionale të tenderuesit.

Autoriteti Kontaktues në përgjigjien pas kërkesës për rishqyrtim ke pretenduar që pasi lëshimi është bërë në të njëjtin cikël kohor gjë e cila nuk qëndron, ndërsa ne i qëndrojmë prapa pretendimit tonë që nuk është i mundur që numri i referencës për dy dokumente te ndryshme të jetë i njëjti dhe me datën e njëjtë, pasi që numri i referencës përdoret për të identifikuar në mënyë unike një dokument dhe jo të shkaktoj konfuzion e aq më pak në të njëjtën datë Si dhe aktivitetet për të cilat është i licesuar kompania lëshuese nuk kanë të bëjnë me certifikatat e lëshuara e aq më pak kur në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë janë kërkuar që këto Certifikata të jenë të lëshuara nga nga kombëtar apo ndërkombëtar, e që nuk përmbushin këtë kërkesë të dosjeës së tenderit.

Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 3- është kërkuar si në vijim: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT duhet te jene ne gjendje te rregullt funksionale - deklarate e operatorit ekonomik qe deshmon se mjetet te cilat i planifikon ti perdore te jene ne gjendje te mire operationale.

Dëshmia 3 – Nga numri 1 deri 15 të dëshmohet me Dokumentin Unik Duganor (nëse Dokumenti Unik Doganor nuk është në emër të OE tenderues, atëherë të ofrohen faturat e blerjes me DUD Doganor në emër të shitësit dhe **dëshmi e pagesës bankare e faturës**). Nga numri 16 deri 18 të dëshmohen me Librezat e Qarkullimi kopje me afat te regjistrimit. Nëse OE nuk i ka ne pronësi këto makineri, duhet të ofroj Marrëveshjet për Shfrytëzim të paisjeve për këtë projekt me dëshmi sipas kërkesës (nuk pranohen marrëveshjet e përgjithshme). Marrëveshja duhet të jetë në emër të

këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët në prezencë të noterit, (AK ruan te drejten e vizites ne terren per verifikim te paisjeve nese është e nevojshme).

- Eskavator me kapacitet minimum 35t min-1copë

Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 075/2021-te dates 06.08.2021- per blerjen e Eskavatorit nga Kompania Lika Trade SHPK ndërsa fatura ka vleren 36,500.00€, ndersa është prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 20,000.00 i dates 10.08.2021 ndersa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për paisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

- Eskavator me kapacitet minimum 30t min-1copë

-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-11-te dates 26.04.2024- per blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndersa fatura ka vleren 85,000.00€, ndersa është prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 20,000.00 i dates 19.04.2024 (ndersa fatura është e dates 26.04.2024)-Fatura e blerjes së Eskavatorit nuk korrespondon me datën e transferit të blerjes për këtë eskavator. Konkretisht fatura e blerjes 24-SHV01-001- 11- e datës 26.04.2024 pagesa e Eskavatori 19.04.2024.

-Eskavator me kapacitet minimum 26t min- 2copë

-1-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-10-te dates 25.04.2024- per blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndërsa fatura ka vleren 68,000.00€, ndersa është prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 10,000.00€ i dates 25.04.2024 ndersa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për paisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

-2-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 21-SHV01-001-10-te dates 19.05.2021- per blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndersa fatura ka vleren 37,000.00€, ndersa është prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 35,000.00€ i dates 09.07.2021. ndersa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për paisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

-Eskavator me gome me kapacitet minimum 16t -2copë

-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-2-te dates 19.01.2024- per blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndersa fatura ka vleren 49,000.00€, ndersa është prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 30,000.00€ i dates 26.12.2023- ku dhe është pagese e profatures 85-2/2023 dhe kontrates 88-2023- ndersa nuk është prezantuar nje profatue qe deshmon avanspagesen e profatures, si dhe asnjë kontratë ndersa shihet qe edhe ka dallim ne mes te çmimit te paisjes ne faturen e paguar dhe avanspageses.

- Ngarkues max 6.5t -1copë

Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-58-te dates 21.03.2024- per blerjen e Ngarkuesit nga Kompania DT Mining SHPK ndersa fatura ka vleren 31,000.00€, ndersa eshte prezantuar nje transfer bankar i cili ka vleren prej 20,000.00€ i dates 21.03.2024 ndersa nuk eshte prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për paisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Siq e sqaruam edhe më lartë ka transfere bankare të cilat vetëm janë transfere bankare, dhe nuk ka specifikim se për cilën faturë është kryer pagesa e që mund të jenë edhe transfere të punëve të kryera dhe nuk janë realizuar ashtu siq ka pretenduar AK që janë realizuar për makineritë përkatëse, pasi që siq e sqaruam secilën prej paisjeve le të kuptohet shumë qartas që nuk janë ofruar Dëshmitë e pagesave për makinëritë, ndërsa AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë shumë qartas e ka specifikuar që të ofrohen dëshmitë bankare(dokument i cili nuk ekziston), ku në këtë rast ky GOE është dashur që të eliminohet nga procedura dhe jo të shpallet i përgjegjshëm.

Ndërsa Operatori Ekonomik i cili është shpallur i përgjegjshëm në të njëjtën kohë ka tejkaluar edhe buxhetin e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit, në rastin konkret në bazë të rregullores për prokurimin publik -Neni 77.14 . Në veçanti, tenderët të cilët sipas autoritetit kontraktues janë anormalisht të ulët ose tenderët çmimi të cilave tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktues siq është përcaktuar në dokumente para inicimit të procedurës së prokurimit do të konsiderohen si të papranueshëm.

Në këtë rast GOE është dashur që të eliminohet nga procedura për tejkalimin e vlerës së parashikuar.

Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohet sqarim si dhe në të njëjtën kohë ka shpallur të përgjegjshëm dhe pretendent për nënshkrim të kontratës edhe një Operator Ekonomik pasi siq edhe shtjelluam më lartë nuk ka përmbushur kërkesat dhe ka ofruar dokumente të dyshimta.

Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE i cili është i pa përshtatshëm dhe i pa përgjegjshëm AK e ka favorizuar drejt për se drejti OE-ne e rekomanduar për kontrate ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejtpërsdrejti.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm dhe ekonomikisht më të favorshëm.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Zyrtaret e AK me këtë vendim po tenton ta dëmtoj buxhetin e Komunës në vlerë prej 105,039.05€ pasi ka pretenduar për të shpërblyer me kontratë një OE më të shtrenjtë sesa neve. Si dhe të keq menaxhohen mbi 462,572.55 € të buxhetit të Komunës.

Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim: Grup i Operatorëve Ekonomikë, Ermal Sylaj B.I.; NNT Bini SH.P.K., Magj. Suharekë - Prishtinë, 23000, Duhël me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën e Suharekës - RITENDER" me numër të prokurimit: 624-24-12927-5-2-1, numër i brendshëm: 624-24-89-521, kundër (NJOFHM VENDIMIT TË AK), të datës: 31.01.2025, të publikuar në uebfaqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 04.02.2025, sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Pretendimi 1 - nuk qëndron: Bazuar në CV-në e punëtorit Ilaz Vokrri, specifikohet se fillimi i punës është viti 2023. Sa i përket ing. Ilaz Vokrri, ai nuk është i regjistruar në sistemin ATK sipas CV-së dhe as sipas Kontratës së Punës. AK ka vepruar në bazë të LPP, neni 52, pika 7.

Pretendimi 2 dhe 4 - nuk qëndron: Sa i përket Draft kontratës, komisioni vlerësues e ka marrë në konsideratë draftin pasi që inxhinierët dhe operatorët ekonomikë janë pajtuar që nëse ai do të bëhet fitues i këtij aktiviteti, atëherë kjo është forma e kontratës që do të aplikohet. Për sqarimin tuaj, në të gjitha dosjet tenderike, ashtu edhe në këtë dosje tenderike, tek pjesa B, paraqitet forma e Draft Kontratës, që nëse një tenderues shpallet fitues, atëherë kjo është forma e kontratës.

Pretendimi 3 - nuk qëndron: Një (1) inxhinier i Gjeodezisë (ose master), duhet të jetë i licencuar dhe të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune pas diplomimit. Me datë 26 nëntor 2021, Shqipëria dhe Kosova nënshkruan një marrëveshje për njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave mes dy vendeve. Sipas MASHT - NARIC KOSOVA - Qendra për Njohje të Diplomave: Procedura për shqyrtimin e kërkesës për njohje/barazvlerë të diplomave të fituara jashtë vendit, nëse lënda është e kompletuar, do të shqyrtohet brenda 4 muajve, përveç diplomuarve në Shqipëri, për të cilët afatet kohore janë të përcaktuara sipas marrëveshjes për njohjen e diplomave të nënshkruara nga Qeveritë përkatëse.

Pretendimi 5 - nuk qëndron: Sa i përket kërkesës 5 dhe 6, ku AK ka kërkuar që të ketë një person të trajnuar për trajtimin e mbetjeve, dhe një person të trajnuar për detyrimin e dhënash, sqarojmë se të dy certifikatat janë të noterizuara në praninë e noterit, dhe për një noterizim të tillë duhet të prezantohet origjinali. Të dy certifikatat posedojnë të njëjtin numër specifik. Në lidhje me numrin e referencës 211/22, dëshirojmë të sqarojmë se ai është i njëjtë në të dyja certifikatat e trajnimit për shkak të "përdorimit të një reference unike për trajnimet e realizuara brenda të njëjtit cikël kohor" në sistemin e brendshëm të administrimit të certifikimeve për pjesëmarrje në trajnime bazike. Gjithashtu, rezulton se kompania BliTERM ENG është e licencuar për:

- Aktivitetet inxhinierike dhe këshillime profesionale

- Licenca 05/2021 MFPT - Zhvillimi i programeve trajnues për Ekspert
- Licenca 04/2018 MPMS - Vlerësimi i riskut në vende pune
- Licenca Nr. 111 AME - Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Ekspert Gjyqësor për Siguri dhe Shëndet në Punë

Pretendimi 6 - nuk qëndron: OE i propozuar për kontratë ka prezantuar Dëgator Doganorë dhe faturat e blerjes së pajisjeve. Transferri bankar është realizuar në emër të secilës faturë, duke specifikuar numrin e faturës në përshkrimin e transaksionit që vërteton se transaksioni bankar është realizuar për ato makineri përkatëse. Është çështje private ndërmjet bizneseve nëse kanë obligime të tjera ndërmjet vete, a është bërë ndonjë shkëmbim apo ndonjë pjesë tjetër kompenzohet me punë ose të tjera; kjo është çështje interne. Nëse AK na ka dëshmuar që financiarisht është në rregull, kjo është e pranueshme.

Pretendimi 7 - nuk qëndron: GOE për këtë procedurë të prokurimit nuk ka tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar të AK-së. Sipas Neni 9 - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, Paragrafi 3, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organ financiar, dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare që do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme, ZKF do të (i) signjojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë baza të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme do të sigurohen mjetet e mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kthen mundësinë e përmbushjes së obligimeve të parashikuara në kontratë, me legjislacionin e ardhshëm të përvetësimeve, të fondeve për përmbushjen, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla."

Për çështje të tejkalimit të buxhetit në mënyrë jo substanciale, praktika paraprake në instanca përgjegjëse siç është OSHP dhe KR.PP, i është lënë në diskrecion të AK-së vlerësimi dhe rishikimi i mjeteve financiare të AK-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0121, ndërsa me datë 28.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0121, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtur lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e Ermal Sylaj B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0121 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi 1

Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT).

Ndërsa në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) e që do të shtjellohen në mënyrë të detajuar edhe më poshtë mirëpo së pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tonë dhe kundërligjshmërinë e Autoritetit Kontraktues për të na eliminuar neve.

GOE ka prezantuar Inxh. Ilaz Hajdin Vokri, Inxh. I ndërtimtarisë Drejtim Hidroteknik, me Kontrate të rregullt pune duke filluar nga data 01.02.2024 me orar të plote dhe CV e të njëjtit rezulton se në kompaninë Bini Shpk ka filluar pune nga viti 2023, ndërsa pas verifikimit në sistemin e ATK –se rezulton se INXH Ilaz Vokri ka filluar pune në kompaninë NBT BINI Shpk në muajin 03/2024 si pune sekondare dhe jo sipas kontratës së firmosur për pune me orar të plote dhe CV e Inxh. Ilaz Vokri nuk korrespondon fare me kontratën dhe lajmërimin në sistemin e ATK-se. Gjithashtu, referenca e Kompanisë NNT BINI Shpk lëshuar ndaj Inxh Ilaz Vokri është e pavlefshme (data e fillimit të punës: 01.05.2023).

Përgjigjja në pretendime

Eksperti shqyrtues ka analizuar dosjen e tenderit lidhur me kriterin që është eliminuar OE ankues në kriterin e kërkuar DT nuk kërkohet të dëshmohet përvoja e punës me ATK e as me referenca që është eliminuar OE ankues.

Në dosjen e tenderit Kërkesa 2 – 1. Një (1) Inxhinier i diplomuar I Ndërtimtarisë (ose master) - hidroteknik min 5 vite përvojë pune pasë diplomimit.

Dëshmia: Për piken 1,2,3 dhe 4 të dëshmohet me diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal e noterizuar nga vetë mbajtësi I saj dhe jo para datës së publikimit të këtij projekti) CV e nënshkruar nga vetë personat dhe kontrata të punës valide të noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim të noterizuara. Si dhe certifikatat e noterizuara nga vetë mbajtësit e saj dhe jo para datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Në bazë të ankuesit, Autoriteti Kontraktues (AK) ka eliminuar padrejtësisht Grupin OE, duke dhënë arsye të paqëndrueshme dhe të pabazuara ligjërisht. Një nga arsyet e përmendura për eliminimin është se kontrata e inxhinierit Ilaz Vokri nuk përputhet me datat e lajmërimit kur është bërë në ATK. Si ekspert konstatoj se në DT është kërkuar të dëshmohet CV e nënshkruar nga vetë personi, e sa i përket eliminimit të CV të Ilaz Vokrit kjo nuk qëndron pasi përvojën e ka të cekur në CV dhe nënshkruar është, kontrata e punës valide në këtë rast OE ankues e ka kontratën, CV sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Gjithashtu OE ankues e ka në ofertë Marrëveshjen e lidhur në mes inxh. Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik Musli Shala dhe kompanisë Ankuese e cila marrëveshje është noterizuar dhe e nënshkruar siç ka qenë kërkesa e

dosjes se tenderit, me këtë si ekspert konstatoj se OE e ka plotësuar kërkesat e dosjes sa i përket Inxh. Ndërtimtarisë Hidroteknike.

Eksperti shqyrtues siç e sqarova dhe më lart, OE i ankues në ofertën e tij ka bashkangjitur dy inxh. Ndërtimtarisë Hidroteknike.

Si rrjedhojë eksperti shqyrtues konsideron se GOE NTSH BUSHI & NNT BINI SHPK ka plotësuar kriterin e vlerësimit e duke u bazuar në 69 të LPP-se dhe në dosjen e tenderit AK-ja nuk ka pas të drejt të eliminoj, ndërsa sa i përket çështjes së Inxh. Ilaz Vokri është i deklaruar në punë sekondare në ATK kjo kërkesë nuk ka që në dosjen e tenderit dhe nuk është në përgjegjësinë e AK-se të vërtetoj punëtorët a janë me ATK si janë. Sa i përket punës sekondare GOE Erst Bau shpk & Arlindi shpk i rekomanduar për kontratë të inxh.. Hidroteknikes Selim Hyseni në CV e prezantuar është punëtor i kompanisë “NPSH Hidroprojekti”, pra qeshja e punës primare e sekondare dhe ATK-se nuk ka qenë kërkesë e DT.

Arsyes e eliminimit të OE ankues si ekspert konstatoj se nuk qëndrojnë, japim sqarimet si në vijim.

Verifikimi i kontratës me ATK të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues si “info për panelin” nuk kanë qenë kërkesë në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj përdorimi i tyre për vlerësim dhe eliminim të operatorit ekonomik sipas mendimit tonë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 7 të LPP-së, paragrafi 6, pika (v) dhe me këtë konstatojmë se arsyet e eliminimit të GOE ankues janë në kundërshtim me këtë nen dhe pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi 2

Ndërsa Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur Fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë e këtë do të shtjellojmë me shkeljet të cilat janë bërë.

2.1 Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 2- është kërkuar si në vijim: Kërkesa 2 – OE duhet të këtë Stafin profesional si për kërkesën: Një (1) Inxhinier i diplomuar I Ndërtimtarisë (ose master) - hidroteknik min 5 vite përvojë pune pasë diplomimit.

Është kërkuar kontrata të punës valide të noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim të noterizuara. Ku për këtë pikë është prezantuar: Selim Hyseni-ndërsa është prezantuar një “Draft” Kontratë pune për detyra specifike, ku në bazë LIGJI Nr. 03/L-212-Neni 10- Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, të caktuar si dhe kontratë për punë dhe detyra specifike, në këtë ligj nuk ekziston lloji “Draft” Kontratë pune për detyrë specifike. Si e tillë kontrata e prezantuar nuk përmbush kërkesën.

2.2 Një (1) Një inxhinier i Gjeodezisë (ose master) - të jetë i licencuar si dhe të ketë min 3 vite përvojë pune pasë diplomimit.

Në Kosovë, nostrifikimi i diplomave universitare të fituara jashtë vendit është i rregulluar nga Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore të nxjerra nga institucionet përkatëse. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që diplomat e fituara jashtë vendit të njihen dhe të konsiderohen të barasvlershme me sistemin arsimor të Kosovës.

2.3 Një (1) Inxhinier i diplomuar I Ndërtimtarisë (ose master) – hidroteknik min 5 vite pervoje pune i certifikuar per organizim dhe menaxhim I kantierit te ndërtimit, i njëjti te jete menaxher i projektit

Është kërkuar kontrata të punës valide te noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim te noterizuara. Ku për këtë pikë është prezantuar: Faton Frangu -Ku për inxhinierin në fjalë është prezantuar “Draft” Kontratë pune për detyra specifike, ku në bazë LIGJI Nr. 03/L- 212-Neni 10-Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, të caktuar si dhe kontratë për punë dhe detyra specifike, në këtë ligj nuk ekziston lloji “Draft” Kontratë pune për detyrë specifike.

Përgjigjja ne pretendim 2

2.1 Ne baze te dokumentacionit qe ka dorëzuar ne ofertë OE fitues si ekspert shqyrtues kam analizuar se a e përmbushë kërkesat e dosjes se tenderit lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit qe ka ngritur ne këtë rast me përmbushjen e kriterëve nga operatori i rekomanduar për kontratë ku konsideroj si më poshtë:

Sa i përket pretendimit se Ligji i pune ligji Nr. 03/L-212 nuk njeh Draft kontratën, si ekspert ne baze te neneve qe ju ka referuar OE i rekomanduar ne kontratë te ligjit te punës ky ligj nuk njeh draft kontratë qe konstatoj se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit pasi është kërkuar “ Kontratë valide” e drafti nuk mundet te konsiderohet kontratë valide. Nëse ne kontrate e lidhura te punëtorëve do te ju referoje ligjit te detyrimeve ky ligj i njeh para kontratat, para kontrata nuk detyron në qoftë se rrethanat, prej lidhjes së saj kanë ndryshuar apo nuk do të lidhej fare po të ekzistonin rrethanat e tilla në atë kohë e qe si ekspert mendoj se mund te cilësohet ekuivalentë e draftit atëherë para kontratë, por ne këtë rast jo se është kërkuar kontratë valide ne DT

2.2 Ne baze pretendimit ankimor lidhur me nostrifikim te diplomës se gjeodetit, Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin lidhur me nostrifikimin e diplomave të inxhinierit të OE fitues dhe vlerëson se AK-ja duhet te kërkoj nostrifikimin e diplomës përputhjen me nenin 72, mirëpo ne mendoj se pasi është licencuar si gjeodet i licencuar nga Agjencia e Kadastrale e Kosovës -Ministria e Mjedisit mendoj se e përmbushë kriterin, por Ak-ja një aspekt duhet të ju kërkon me vërtetu a është në përputhje me ligjin në fuqi Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji Nr. 04/L-037 dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit qe ti largon dyshimet qe te vërtetohet se plotësohet kriteri e ti kërkohet sipas nenit 72. Pretendimi pjesërisht i qëndrueshëm.

2.3 Sa i përket pretendimit për Inxhinier i diplomuar I Ndërtimtarisë (ose master) – hidroteknik min. 5 vite përvojë pune i certifikuar per organizim dhe menaxhim I kantierit te ndërtimit, i njëjti te jete menaxher i projektit, përgjigjja e ekspertit do te jetë e njëjtë me 2.1.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi 3

Një person i trajnuar për trajtimin e mbetjeve inerte & 6. Një person i trajnuar për drenazhim te dheut, Për piken 5 dhe 6 te dëshmohet me kontrata te punës ose marrëveshje mbi angazhim ne këtë projekt dhe certifikatat e noterizuar nga vete mbajtësit e saj te lëshuar nga kombëtare apo ndërkombëtare dhe jo para datës te publikimit te njoftimit per kontrate.

Të dy certifikatat e prezantuara për këta dy persona janë certifikata të falsifikuara pasi që numër i referencës si dhe datë të njëjtë të lëmit po i njëjti për të dy persona të ndryshëm. Ndërsa është kërkuar që këto certifikata të jenë të lëshuara nga kombëtare apo ndërkombëtare, ndërsa lëshuesi i kësaj Certificate: Bazuar në kërkesat ligjore, përkatësisht Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-161 dhe Rregulloren përkatëse 01/2021 të MPMS, kompania Bliterm ENG posedon Licencë për ushtrimin e veprimtarive në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MFPT dhe nuk Organ i Akredituar apo i Certifikuar nga MPMS. për trajnime për mbetjen Inerte si dhe Trajnime për Sistemet e Drenazhimit.

Përgjigjja ne pretendim 3

Sa i përket dy certifikatave që ju ka referuar për punëtorët Bekim Idrizi dhe Leutrim Hyseni se janë të falsifikuara, unë si ekspert kame kërkuar nga kompania e licencuar BLITERM ENG – Prishtine Kosove që të na dërgojnë këto certifikata ose nr. Referencës për këta dy persona: Shikoni pyetjen që ju ka dërguar:

Ne baze të përgjigjes që na kanë dërguar kompania BLITERM ENG, certifikata e lëshuar janë identike me ato të dorëzuara në oferte, me këtë konstatoj si ekspert certifikatat Bekim Idrizit dhe Leutrim Hysenit nuk janë të manipuluar siç pretendon GOE ankues. Certifikatat janë me të njëjtin numër të referencës e kanë personat që kanë ndjekur trajnimin në të njëjtën kohë për këtë e kanë nr. Ref. Të njëjtë. Shih përgjigjen që e kemi vërtetuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit se në dosje janë kërkuar që certifikatat të jenë të lëshuar kombëtare apo ndërkombëtare, në baze të LPP-se dhe interpretimit të KRPP-se duhet të njihen certifikata edhe vendore pra që lëshohen nga kompanitë që janë të licencuar Vendore.

Këto certifikata që janë kërkuar nga AK-ja kanë qëllimin sigurimin e punëve që kanë me u krye nga kompanitë ekzekutuese të punëve dhe këto kompani duhet ti plotësojnë në këtë Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.

Duke u bazuar në nenin 31 të LPP-se në përputhje me paragrafin 2.5 të nenit 69 të LPP-dhe në RRPP nenin 26 si ekspert shqyrtues në rast të kontratave për punë, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

Shih nenin 31:

Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

Shih RPP nenin 26

Në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 i LPP-se, Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që

kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se dhe që janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontrate kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit.

Ne baze të kësaj AK-ja nuk ka cek se nga cili trup akreditues duhet të jenë certifikata e punëtorëve në këtë rast kompania që i ka lëshuar certifikatat është e licencuar edhe nga Ministria e Punëve dhe nga Ministria e Financave sipas veb-sajdit të kësaj kompanie “Bliterm ENG” që i ka publikuar në internet.

Pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Pretendimi 4

Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 3- është kërkuar si në vijim:

4.1 Ekskavator me kapacitet minimum 35t min-1 copë

Erst Bau SHPK ka prezantuar faturën 075/2021-te datës 06.08.2021- për blerjen e Ekskavatorit nga Kompania Lika Trade SHPK ndërsa fatura ka vlerën 36,500.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 20,000.00 i datës 10.08.2021 ndërsa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për pajisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

4.2 Eskavator me kapacitet minimum 30t min-1 copë

-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-11-te datës 26.04.2024- për blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndërsa fatura ka vlerën 85,000.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 20,000.00 i datës 19.04.2024 (ndërsa fatura është e datës 26.04.2024)-Fatura e blerjes së Eskavatorit nuk korrespondon me datën e transferit të blerjes për këtë ekskavator. Konkretisht fatura e blerjes 24-SHV01-001- 11- e datës 26.04.2024 pagesa e Ekskavatori 19.04.2024.

4.3 Eskavator me kapacitet minimum 26t min- 2 copë

1-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturën 24-SHV01-001-10-te datës 25.04.2024- për blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndërsa fatura ka vlerën 68,000.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 10,000.00€ i datës 25.04.2024 ndërsa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për pajisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues

-2-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturën 21-SHV01-001-10-te datës 19.05.2021- për blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndërsa fatura ka vlerën 37,000.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 35,000.00€ i datës 09.07.2021. ndërsa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për pajisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën

e Autoritetit Kontraktues.

4.4 Eskavator me gome me kapacitet minimum 16t -2copë

-Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-2-te datës 19.01.2024- për blerjen e Eskavatorit nga Kompania Blerim Demhasaj B.I ndërsa fatura ka vlerën 49,000.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 30,000.00€ i datës 26.12.2023-ku dhe është pagese e pro faturës 85-2/2023 dhe kontratës 88-2023- ndërsa nuk është prezantuar një profatur qe dëshmon avans pagesën e pro faturës, si dhe asnjë kontratë ndërsa shihet qe edhe ka dallim ne mes te çmimit te pajisjesh ne faturën e paguar dhe avans pagesës.

4.5 Ngarkues max 6.5t -1copë

Erst Bau SHPK ka prezantuar faturen 24-SHV01-001-58-te datës 21.03.2024- për blerjen e Ngarkuesit nga Kompania DT Mining SHPK ndërsa fatura ka vlerën 31,000.00€, ndërsa është prezantuar një transfer bankar i cili ka vlerën prej 20,000.00€ i datës 21.03.2024. ndërsa nuk është prezantuar asnjë dëshmi tjetër për pagesën e kësaj fature, ku në dëshmitë për pajisjet në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është specifikuar shumë qartas që të prezantohet Dëshmi e pagesës bankare e faturës. E në këtë rast dëshmia e prezantuar nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Siç e sqaruam edhe më lartë ka transfere bankare të cilat vetëm janë transfere bankare, dhe nuk ka specifikim se për cilën faturë është kryer pagesa e që mund të jenë edhe transfere të punëve të kryera dhe nuk janë realizuar ashtu siç ka pretenduar AK që janë realizuar për makineritë përkatëse, pasi që siç e sqaruam secilën prej pajisjeve le të kuptohet shumë qartas që nuk janë ofruar Dëshmitë e pagesave për makineritë, ndërsa AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë shumë qartas e ka specifikuar që të ofrohen dëshmitë bankare(dokument i cili nuk ekziston), ku në këtë rast ky GOE është dashur që të eliminohet nga procedura dhe jo të shpallet i përgjegjshëm.

Përgjigjeje ne pretendimin 4

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne LPP AK-ja e ka për obligim në përputhje me nenin 59 të të sigurojë që ofertat e dorëzuara i plotësojnë kriteret e kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ti jepet kontrata operatorit ekonomik që përmbush kriteret. Ak-ja ne këtë rast ka kërkuar ne DT

Dëshmia 3 – Nga numri 1 deri 15 të dëshmohet me Dokumentin Unik Duganor (nëse Dokumenti Unik Doganor nuk është në emër të OE tenderues, atëherë të ofrohen faturat e blerjes me DUD Doganor në emër të shitësit dhe dëshmi e pagesës bankare e faturës).

Sa i përket pretendimit 4.1 Ekskavator me kapacitet minimum 35t min-1 copë nuk përputhet vlere e transferit me faturën ndryshimi është i madh 16.500.00 € duhet ti vërtetoj AK-ja pasi mundet te konsiderohet mashtrim për AK-ne pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 4.2 Ekskavator me kapacitet minimum 30t min-1copë vlere e faturës se ekskavatorit është shume e madhe 85,000.00 € ndërsa transferi është 20.000.00 € ky ndryshim i vlerës nuk mundet te cilësohet se është plotësuar kriteri i kërkuar i dosjes se tenderit pasi AK-ja duhet ti vërtetoj këto makineri se a janë ne posedim te GOE te rekomanduar. Kriteri i DT ka qene “dëshmia e pagesës bankare e faturës” kjo pages – transfer nuk përputhet me faturën dhe për këtë arsyeje duhet ti vërtetoj AK-ja ne baze te nenit 72 për dëshmitë qe janë para publikimit te njoftimit për kontratë. Pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Ne baze te ofertës se OE te rekomanduar për mjetet qe i ka ngritur si pretendime ankimore për 4.3 Eskavator me kapacitet minimum 26t min- 2copë vlera e faturës me transferet bakare nuk përputhen dhe ndryshimi është shume i madh ne mes transferit dhe faturës për nga vlera si ekspert konstatoj se pretendimi pjesërisht i bazuar.

Gjithashtu sa i përket pretendimit 4.4 Eskavator me gome me kapacitet minimum 16t -2copë këtu me pare është bere transferi e tani është lëshuar fatura për pagesa, por te këta eskavator nuk përputhet vlera mendoj se duhet te jetë shqetësues se mos ka ra lajthitje AK-ja pasi transferi ka tjetër numër te pro-faturës dhe është cekur kontrata për qa është bere transferi kështu qe AK-ja duhet ti vërtetoj këto ne teren apo kërkoj dëshmi shtesë për dokumente qe janë para njoftimit për kontratë - pretendimi është i bazuar.

Pretendimi 4.5 Ngarkues max 6.5t -1copë gjithashtu edhe te ky pretendim nuk përputhet vlera e faturës me transferin qe konstatoj se nuk është plotësuar kriteri i kërkuar i dosjes se tenderit dhe AK-ja duhet te respektoj nenin 59, 69 te LPP-se duke respektuar kriteret qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit. Si ekspert konstatoj se pretendimi është i pjesërisht bazuar.

Pretendimi 5

Ndërsa Operatori Ekonomik i cili është shpallur i përgjegjshëm në të njëjtën kohë ka tejkualuar edhe buxhetin e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit, në rastin konkret në bazë të rregullores për prokurimin publik -Neni 77.14 . Në veçanti, tenderët të cilët sipas autoritetit kontraktues janë anormalisht të ulët ose tenderët çmimi të cilave tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktues siç është përcaktuar në dokumente para inicimit të procedurës së prokurimit do të konsiderohen si të papranueshëm. Në këtë rast GOE është dashur që të eliminohet nga procedura për tejkalimin e vlerës së parashikuar.

Përgjigjeje për pretendimin 5

Ne baze te LPP-se nenit 62 nuk ceket se decidivisht duhet te anulohet oferta e cila e tejkalon buxhetin por as nuk ceket se duhet te anulohet aktiviteti i prokurimit ne rast te tejkalimit te buxhetit, pra Autoriteti Kontraktues sigurohet se çmimet e ofruara në ofertën më të lirë janë çmime reale të tregut si dhe mund të siguroj mjete shtesë me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA, për atë aktivitet të prokurimit, mund të vazhdoj me procedurë.

Gjithashtu ne baze te RRPP Gjithashtu, neni 4 përkatësisht paragrafi 4.1 pika a, b dhe c të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nuk ceket se duhet te anulohet aktiviteti i prokurimit ose duhet te eliminohet oferta qe tejkalon buxhetin. Pretendimi nuk qëndron.

Pretendimi 6

AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm dhe ekonomikisht më të favorshëm.

Përgjigjeje për pretendimin 6

Sa i përket pretendimit ankimor se nuk është respektuar neni 59 dhe 60 i LPP-se konstatoj si ekspert se kompania ankues është me çmim me te ulet ne vlere prej 105,039.05 € qe si ekspert

konstatoj se AK-ja Komuna e Suharekës nuk ka vlerësuar sipas nenit 59 dhe 60 të LPP-se . Gjithashtu arsyeja mbi eliminimin që ju është dërguar GOE ankues nuk qëndron pasi e ka plotësuar, e në bazë të LPP-se kur Operatorët Ekonomikë i plotësojnë kriteret e dosjes së tenderit atëherë duhet të rekomandohet OE i cili e ka çmimin më të ulët që të respektohet kriteri për dhënin e kontratës çmimi më i ulët. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Si konkluzion përfundimtar OE ankues i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, arsyet që është eliminuar nuk qëndrojnë, kontrata e punës nuk është kërkuar të përputhet me ATK në dosje e tenderit nuk është kërkuar që të jetë në përputhje me ATK kjo është përgjegjësi e OE me ATK. Nëse nuk e lajmërohet në ATK ky dënohet nga ATK-ja që kjo është përgjegjësi e OE dhe ATK-se.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si ofertues i përgjegjshëm me arsyetimin e prezantuar në letrën standarde për tenderues të eliminuar ngase GOE ka prezantuar Ingj. Ilaz Hajdin Vokri, Ingj. I ndërtimtarisë Drejtim Hidroteknik, me Kontratë të rregullt pune duke filluar nga data 01.02.2024 me orar të plotë dhe CV e të njëjtit rezulton se në kompaninë Bini Shpk ka filluar punë nga viti 2023, ndërsa pas verifikimit në sistemin e ATK –se rezulton se ING Ilaz Vokri ka filluar punë në kompaninë NBT BINI Shpk ga muaji 03/2024 si punë sekondare dhe jo sipas kontratës së firmosur për punë me orar të plotë dhe CV e Ingj. Ilaz Vokri nuk korrespondon fare me kontratën dhe lajmërimin në sistemin e ATK-se. Gjithashtu, referenca e Kompanisë NNT BINI Shpk leshuar ndaj Ing Ilaz Vokri është e pavlefshme (data e fillimit të punës: 01.05.2023).

Paneli Shqyrtues lidhur me konstatimin e ekspertit shqyrtues thekson faktin që eksperti shqyrtues nuk i ka pasur parasysh ë gjitha dispozitat ligjore të cilat janë të përcaktuara deri tek finalizimi apo përfundimi i tërësishëm i një aktiviteti të prokurimit. Është fakt se neni 56.3 i LPP përcakton se AK nuk ka të drejtë të eliminoj një OE për ndonjë kërkesë/kriter i cili nuk është i përcaktuar në Dosje të Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë, por duke u bazuar në nenin 52.7 të LPP, Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit, dhe pikërisht AK duke hasur në mos përputhje në mes të datave të kontratës së rregullt dhe datave CV e këtij inxhinieri, ka filluar të kryej një kontroll dhe verifikim në ATK dhe ka rezultuar se për inxhinierin në fjalë ka ka mospërputhje të deklarimeve dhe administrativisht duhet eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, andaj, PSH e mbështetë plotësisht arsyetimin e AK në këtë rast të dhënë në Letrën Standarde për eliminimin e këtij OE dhe konsideron se veprimet e AK janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore dhe nënligjore të LPP.

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se AK në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur Fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 2 Inxhinier i diplomuar I Ndertimtarise (ose master) – hidroteknik. Është kërkuar kontrata të punës valide te noterizuara ose marrëveshje mbi angazhim te noterizuara. Ku për këtë pikë është prezantuar: Selim Hyseni-ndërsa është prezantuar një “Draft” Kontratë pune për detyra specifike, ku në bazë LIGJI Nr. 03/L-212-Neni 10- Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, të caktuar si dhe kontratë për punë dhe detyra specifike, në këtë ligj nuk ekziston lloji “Draft” Kontratë pune për detyrë specifike. Si e tillë kontrata e prezantuar nuk përmbush kërkesën.Pastaj Një inxhinier i Gjeodezisë (ose master) - te jete i licencuar. Në Kosovë, nostrifikimi i diplomave universitare të fituara jashtë vendit është i rregulluar nga Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore të nxjerra nga institucionet përkatëse. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që diplomat e fituara jashtë vendit të njihen dhe të konsiderohen të barasvlershme me sistemin arsimor të Kosovës.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj, Paneli Shqyrtues pretendimin rreth draft kontratës e kualifikon si pjesërisht të bazuar, por duke u nisur nga fakti se këtu nuk kemi të bëjmë me kontratë të rregullt por me një marrëveshje për angazhim në rast se fitohet kontrata, atëherë Paneli Shqyrtues në aspektin ligjor konsideron se ka një peshë të njëjtë në mes të “Draft Kontratës” dhe “Para kontratës (marrëveshje për angazhim)” në këtë rast, ngase asnjëra nga këto nuk mund të jenë të zbatueshme dhe efektive për

derisa nuk fitohet dhe fillohet projekti në fjalë. Këtë e kanë përcaktuar edhe palët nënshkruese në nenin 1 të këtij dokumenti. Përveç kësaj Paneli Shqyrtues nuk ka hasur ndokund në Dosje të Tenderit apo Njoftim për Kontratë rreth ndonjë forme të caktuar apo specifike rreth përmbajtjes apo përshkrimit të një marrëveshje në rast të angazhimit në këtë projekt.

Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka vepruar drejtë dhe ka japur arsyetim të qëndrueshëm rreth nostrifikimit të diplomës së Inxhinierit të Gjeodezisë ngase sipas MASHT dhe Qendrës Kombëtare për Nohje dhe Informim Akademik në nëntor të vitit 2021, Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kishin nënshkruar një marrëveshje për njohje të diplomave mes të dyja shteteve. Përveç kësaj, Paneli Shqyrtues thekson se në bazë të nenit 59 të LPP, vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave bëhet vetëm në bazë të kërkesave të përcaktuara nga AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, e në këtë rast as në Dosje të Tenderit dhe as në Njoftim për Kontratë nuk ka qenë kërkesë që kontratat të jenë në nostrifikuara dhe në kuptim të nenit 56.3 të LPP, asnjë OE nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e specifikuar në këto dy dokumente, citat i kësaj dispozite: *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*

Ankuesi pretendon se lidhur me kërkesën që Nje person i trajnuar per trajtimin e mbetjeve inerte & 6. Nje person i trajnuar per drenazhim te dheut, Për piken 5 dhe 6 te deshmohet me kontrata te punes ose marrëveshje mbi angazhim ne kete projekt dhe certifikatat e noterizuar nga vete mbajtësit e saj te leshuar nga kombetare apo nderkombetare dhe jo para dates te publikimit te njoftimit per kontrate. Të dy certifikatat e prezantuar për këta dy persona janë certifikata të falsifikuara pasi që numër i referencës si dhe datë të njëjtë të lëmit po i njëjti për të dy persona të ndryshëm. Ndërsa është kërkuar që këto certifikata të jenë të lëshuara nga kombetare apo ndërkombetare, ndërsa lëshuesi i kësaj Certificate: Bazuar në kërkesat ligjore, përkatësisht Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë 04/L-161 dhe Rregulloren përkatëse 01/2021 të MPMS, kompania Bliterm ENG posedon Licencë për ushtrimin e veprimtarive në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MFPT dhe nuk Organ i Akredituar apo i Certifikuar nga MPMS. për trajnime për mbetjen Inerte si dhe Trajnime për Sistemet e Drenazhimit.

Eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës ka deklaruar dhe ka bërë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të këtyre verifikimeve na nevojë që të njëjtat të përshkruhen sërish ka rezultuar se këto certifikata janë në rregull dhe AK ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të DT, andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Ankuesi po ashtu atakon OE të rekomanduar për kontratë edhe sa i përket mjeteve dhe pajisjeve të cilat janë të domosdoshme për kontratë, ashtu sikurse janë për shkruar në ankesën e ankuesit dhe në përgjigje të pretendimit ankimor nr. 4 të raportit të ekspertizës (pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen sërish). Paneli Shqyrtues në këtë rast e mbështet arsyetimin e dhënë nga AK se OE i propozuar për kontratë ka prezantuar Dudat Doganorë dhe faturat e blerjes së pajisjeve. PO ashtu është evidente fakti se edhe Transferet bankare janë realizuar në emër të secilës faturë, duke

specifikuar numrin e faturës në përshkrimin e transaksionit që vërteton se transaksioni bankar është realizuar për ato makineri përkatëse. Andaj, PSH konsideron se AK nëse dyshon për ndonjë transfer ap dokument i cili nuk është bërë në mënyrë të rregullt mund të kryej një kontroll efektiv konform nenit 52.7 të LPP.

Ankuesi po ashtu pretendon se GOE i shpallur fitues është dashur që të eliminohet nga procedura për tejkalimin e vlerës së parashikuar PSH konsideron se nuk është e domosdoshme që të eliminohet një OE në rast se bëhet tejkalimi i vlerës së parashikuar ngase sipas rregullave të thesarit Autoriteti Kontraktues i lejohet që në rast se sigurohet se çmimet e ofruara në ofertën më të lirë të përgjegjshme janë çmime reale të tregut atëherë mund të siguroj mjete shtesë me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA, për atë aktivitet të prokurimit dhe mund të vazhdojë me procedurë. Dmth kjo është në varësi të vetë vlerësimeve të AK, të cilët duhet të mbajnë edhe përgjegjësi. Ky konstatim është edhe në mbështetje të nenit 62 të LPP, ngase dhe Rregullores për Prokurim Publik ngase nuk ceket askund se detyrimisht duhet të anulohet oferta e cila e tejkalon buxhetin por edhe të anulohet aktiviteti i prokurimit në rast të tejkalimit të buxhetit. Në nenin 62, paragrafi 2, i lenë mundësin AK “mund” të anulohet në rast të tejkalimit të buxhetit por jo domosdoshmërisht.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar me kujdes pretendimet ankimore të OE ankues si dhe konstatimet e autoritetit kontraktues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore me shumicë janë të pabazuara përveç njërit pretendim i cili është kualifikuar si pjesërisht i bazuar. Andaj, Paneli i ka falur besimin e plotë elaborimeve të autoritetit kontraktues në vendimin e datës 31.01.2025 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 07.02.2025. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues nuk ka arritur që të dëshmoj administrativisht dhe të jetë konform kërkesave të dosjes së tenderit prandaj vendimi i AK është i bazuar në raport me OE ankues.

Paneli Shqyrtues konsideron se nuk ekzistojnë argumente ligjore mbi bazën e të cilave do të duhej që aktiviteti i prokurimit të kthehej në rivlerësim sikurse kërkon OE ankues. Kjo pasi që në rast të rivlerësimit nuk ekzistojnë argumente sipas të cilave do të mund të ndryshonte epilogu i aktivitetit të prokurimit për shkak të faktit se OE ankues ka dorëzuar ofertë administrativisht të përgjegjshme sipas arsyeve të evidentuara më sipër.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, për faktin e njërit pretendim i cili është kualifikuar si pjesërisht i bazuar, ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Suharekës i datës 31.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunë - Suharekë - RITENDER” me numër të prokurimit: “624-24-12927- 5-2-1, duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Ermal Sylaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: